



Pranimi / Dorëzimi Pritjen / Prilaz Received / Delivery	28.04.2023	3	viti god year
Organ / Shërbimi Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojtja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHIK	3948	2023	115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.434/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti -Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.434/2023 të datës 28.02.2023 të parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_, me adrese banimi rruga \_\_\_\_\_

kundër organit të punësimit/Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.434/2023 e datës 28.02.2023 e parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_
- II. MBETET në fuqi Vendimi me numër protokoli 133 i datës 31.01.2023, lidhur me shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje" ndaj ankueses nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ndaj ankueses \_\_\_\_\_ e punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, sipas Akt emërimit me numër AE.Nr.068/2022 të datës 26.07.2022 në pozitën "Zëvendës Drejtor në Qendrën Korrektuese në Dubravë", me datën 31.01.2023, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, përmes Vendimit me numër protokoli 133 ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje" mbi bazën e të gjeturave në raportin përfundimtar të datës 23.12.2022, i hartuar nga ana e anëtarëve të komisionit hetimor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me arsyetimin se në të njëjtin janë gjetur shkelje në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi që dalin nga vendi i punës, nga ana e ankueses.

Ankuesja e pakënaqur me vendimin lidhur me shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje" të datës 31.01.2023, nga ana e Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me datën 28.02.2023 përmes e-mailit zyrtar [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net) ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 2155/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të: - Mos zbatimit të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtareve Publikë si dhe Moszbatimit të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 08.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datën 20.03.2023, ka pranuar nga Shërbimi Korrektues të Kosovës përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Me datën 12.04.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK/2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.prot:2155/2023 të datës 28.02.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 31.01.2023 lidhur me shqiptimin e masës disiplinore nga zv. i Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së; E-mailin zyrtar të datës 01.02.2023 lidhur me pranimin e vendimit nga ankuesja; Kërkesën për përgjigjen në ankesë të datës 08.03.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 20.03.2023 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Raportin përfundimtar të hetimeve të datës 15.12.2022; Raportin final të hetimeve të datës 15.12.2022 nga zv. i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Formularin e intervistës së datës 22.11.2022 lidhur me marrjen në pyetje të ankueses; Formularët e intervistës së datës 22.11.2022 lidhur me marrjen në pyetje të nëpunësit      Formularët e intervistës së datës 22.11.2022 lidhur me marrjen në pyetje të nëpunësit      Formularët e intervistës së datës 22.11.2022 lidhur me marrjen në pyetje të nëpunësit      Formularët e intervistës së datës 22.10.2022, 22.11.2022 dhe 27.11.2022 lidhur me marrjen në pyetje të      Formularët e intervistës së datës 19.10.2022 lidhur me marrjen në pyetje të      Formularët e intervistës së datës 19.10.2022 lidhur me marrjen në pyetje të      ; Deklaratën e dhënë nga      të datës 17.10.2022, 19.10.2022; Raportin e incidentit të datës 12.10.2022 nga Udhëheqësi i Pavijonit në      . Dubravë; Vendimin e datës 17.10.2022 zv.e Drejtorit të QK në Dubravë; Rekomandimin e datës 17.10.2021 të Komisionit hetues në SH.K.K; Vendimin e datës 13.10.2022 të zv. se Drejtorit të QK në Dubravë; Raportin iniciues disiplinor të datës 12.10.2022; Procesverbalin e datës 13.10.2022; Formularin e llogaritjes së dënimit të datës 06.07.2022; Aktgjykimin me numër PK.nr.369/20 të datës 28.06.2022 të Gjykatës Themelore në Gjakovë; Kërkesën e datës përmes e-mailit zyrtar 11.06.2021; E-mailat zyrtar të datës 03.08.2022; Kërkesën përmes e-mailit zyrtar të datës 22.12.2021 lidhur me hetimin e rastit të keqpërdorimit të detyrës zyrtare; E-mailat zyrtar të datës 27.08.2021 03.11.2021, 09.11.2021, 02.11.2020, , 03.08.2022, 27.08.2021, 23.08.2021; Akt emërimit të ankueses me numër      ..nr.068/2022 të datës 26.07.2022 së bashku me formularin mbi përkrahimin e detyrave të punës, si dhe Vendimin VK/2023 të datës

12.04.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me vazhdimin e afatit te ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesja është e *pabazuar*, sepse:

Me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020 përkatësisht me nenin 4 paragrafin 1 është përcaktuar se: *"Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë"*, nga rrjedh se me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë themelimi, ndryshimi, përfundimi i marrëdhënies së punës si dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënia e punës për zyrtarët e shërbimit korrektues i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit për nëpunësit civil dhe ligjeslacionit të veçantë.

Po ashtu Kolegji, me rastin e shqyrtimit të kësaj lënde ka marrë parasysh specifikat e institucionit sikurse edhe çështjen e legjislacionit të veçantë i përcaktuar si në nenin 4 paragrafin 2 nën paragrafët 2.1, 2.2, 2.3, 2.4 dhe 2.5 ku përcaktohet se: *"Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve"*.

Në bazë të shkresës së përgjigjes në ankesë të datës 20.03.2023 e ofruar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës, sipas kërkesës sonë është bashkangjitur edhe shkresa me përshkrimin e detyrave të punës për pozitën të cilën e ushtron ankuesja *"Zëvendës Drejtoreshë"*, ku ndër të tjera ka përcaktuar se detyrat kryesore për këtë pozitë janë se: *"Në mungesë të drejtorit siguron implementimin e strukturës së udhëheqjes dhe organizimit....., Mbikëqyrë personelin drejtpërdrejtë apo përmes vartësve nën mbikëqyrjen e tij; Kryen inspektime ditore në lokalet e burgut; Mban përgjegjësi për procesin e planifikimit të dënimit; Merret me çështjet e disiplinës për personelin dhe të burgosurit"*, ndërsa i raporton Drejtorit të Qendrës Korrektuese në Dubravë.

Bazuar në raportin përfundimtar të hetimeve i hartuar nga Komisioni Hetues i Ministrisë së Drejtësisë-Shërbimi Korrektues të Kosovës me numër 1382 të datës 23.12.2022, lidhur me gjetjen e kontrabandës së një telefoni mobil *"Samsung"* me datën 12.10.2022 në Pavijonin 4J 2/09 në Qendrën Korrektuese në Dubravë, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe dhënies së rekomandimeve të këtij komisioni lidhur me përgjegjësinë disiplinore të ankueses, ka konstatuar se tek rasti i ankueses tek të gjeturat dhe konkluzionet e raportit hetimor në fjalë është konstatuar si në vijim, citoj: *"Zëvendësuesi i Drejtorit QK.Dubravë Zyrafete Imeri, ka qenë e njoftuar përmes e-mailit sa ka qenë në një trajnim në SHBA. Në lidhje me telefonin që e posedojnë të burgosurit në dhomën e Pavijonit 4J 2/09"*, andaj ndër lidhur me këtë edhe ka konstatuar se edhe pse në bazë të shkresave të lëndës të dërguara nga organi i punësimit tanimë ankuesja ka qenë e njoftuar lidhur me shfrytëzimin e telefonit samsung nga të burgosurit në dhomën e Pavijonit 4J 2/09, e njëjta nuk ka ndërmarr asnjë veprim lidhur me evitimin e kësaj dukurie duke e ditur rolin e saj në zingjirin ndërveprues të hierarkisë pranë institucionit të Shërbimit Korrektues dhe se ky veprim në këtë rast nuk ka funksionuar fare

nga ana e ankueses lidhur me dhënien e urdhërave apo reagimin për një situatë të tillë, për shkak se nuk janë ndërmarrë veprimet e duhura në kohën reale për evitimin e rastit në fjalë. Kolegji konstaton se ankuesja në bazë të përshkrimit të detyrave të punës ka qenë e obliguar të menagjojë situatën në atë mënyrë që kur është në pyetje siguria dhe mbarëvajtja e punës së të burgusurve, të reagoj dhe të ndërmarr veprimet e duhura për zgjidhjen e situatës në mënyren sa më të mirë dhe më të lehtë, e meqënëse ky veprim ka munguar nga ana e saj, Kolegji konstaton se e njëjta është përgjegjëse lidhur me mos menaxhimin e kësaj situate që si rezultat i krejt kësaj edhe ka ndodhur futja e këtij telefoni dhe është zhvilluar lirshëm kontrabanda në këtë institucion pa u penguar dhe pa pasur veprim parandalues nga zingjiri hierarkik, duke e ditur dhe pasur parasysh edhe faktin se të burgosurit sipas rekomandimit të datës 17.10.2021 i ishte shqiptuar edhe masa disiplinore nga ana e Komisionit Hetues të SHKK-së me shtatë (7) dite vetmi lidhur me gjetjen e telefonit me datën 12.10.2022 gjatë bastisjes së dhomës. Ndërlidhur me situatën e krijuar, Kolegji vlerëson se ankuesja edhe gjatë marrjes në pyetje nga Komisioni Hetues me datën 22.11.2022 ka deklaruar si në vijim, citoj: *"Po jam njoftuar përmes e-mailit nga zv.Drejtori si "CC", në këtë kohë kam qenë në trajnim në SHBA, kam menduar që kjo çështje ka qenë e përfunduar nga vartësit e mi", duke pranuar në një mënyrë fajësinë e saj dhe duke mos ndërmarrë veprime të duhura nga roli i saj si zv.Drejtoreshë e këtij institucioni.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka analizuar edhe Vendimin me numër 133 të datës 31.01.2023 i nxjerrë nga ana e Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës lidhur me shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje", ku për rastin e ankueses ka elaboruar veprimet përgjegjëse të ankueses dhe me këtë rast ka konstatuar se vendimi në fjalë është i bazuar ngase ankuesja me rastin e mos përmbushjes së detyrave të punës është përgjegjëse për shkeljet e kryera, ashtu siç përcaktohet në nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.4 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar"*.

Po ashtu, Kolegji me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses ka analizuar edhe dispozitat e nenit 45 të Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"* si dhe nenit 50 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *"Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shikallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit. 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer. 3. Për shkeljet e rënda, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafët 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji. 4. Për shkeljet e lehta, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji. 5. Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore"* dhe ka konstatuar se masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankueses ka qenë në proporcion me shkeljen e kryer, duke qenë në dijeni për rastin në fjalë dhe mos reagimin nga ana e saj lidhur me evitimin e pasojave të mëtuqjeshme, veprimet e tjera të mëhershme me qëllim kufizimit të dëmit, andaj bazuar në të gjeturat dhe konstatimet e pasqyruara si më lartë, pretendimet e ankueses janë të pabazuara në ligj dhe njëkohësisht të paqëndrueshme.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.434/2023, datë 28/04/2023.

Ardita/Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së